



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Buletini i Njoftimeve Publike

Nr.50

Datë 19.04.2022

Agjencia e Prokurimit Publik

Blv "Dëshmorët e Kombit"

Tel: + 355 4 2277510

e-mail: info.app@app.gov.al

<https://www.app.gov.al>



- b) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- c) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

II. Dokumentacioni dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
- 2. Jetëshkrimin (cv) sipas formatit standard;
- 3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- 4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar;
- 5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
- 6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqesore;
- 7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 20.04.2022 pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e sipërcituar.

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Njoftim

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, paketës ligjore për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit, Programit të Qeverisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për aplikimin në programet aktive të tregut të punës, për vitin 2022 nga Buxheti i Shtetit është akorduar fondi prej 550 milion lekë për programet e nxitjes së punësimit.

Mbështetur në miratimin e planifikimit dhe shpërndarjes së fondeve dhe të treguesve të monitorueshëm për programet e nxitjes së punësimit për vitin 2022, të përgatitur nga AKPA dhe miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresë nr.485/1 prot, datë 06.04.2022 të “Shpërndarjes së fondeve dhe pjesëmarrësve në Programet e Nxitjes së Punësimit për vitin 2022”

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive hap aplikimet për programet e nxitjes së punësimit për vitin buxhetor 2022 duke njoftuar të gjithë punëdhënësit e interesuar për aplikimin online në portalin e-albania për VKM Nr.17, datë 15.01.2020 dhe VKM Nr. 608, datë 29.07.2020 ndërsa në portalin <https://puna.gov.al/profili/punedhenes/nxitjaPunesimit> për VKM Nr.535, datë 08.07.2020 dhe <https://puna.gov.al/profili/punekerkesues/programVetepunesimi> për VKM Nr.348, datë 29.04.2020 ose në zyrat përkatëse të institucionit përgjegjës për punësim dhe aftësitë në programet sipas VKM-ve si më poshtë:

- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.17, datë 15.01.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”i ndryshuar,
- Vendimit Nr. 348, datë 29.4.2020 “ Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet Vetëpunësimit”,
- Vendimit Nr. 535, datë 8.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet”,
- Vendimit Nr. 608, datë 29.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19”, i ndryshuar.

Afati për të aplikuar dhe dorëzuar dokumentacionin për të gjithë punëdhënësit e interesuar fillon nga data e publikimit të Njoftimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të APP-së.

Bashkëlidhur gjeni “Shpërndarja e Fondit dhe pjesëmarrësve në Programet e Nxitjes së Punësimit për vitin 2022”.

Shpërndarja e Fondit dhe pjesëmarrësve në Programet e Nxitjes së Punësimit për vitin 2022																	
Drejtori Rajonal e të AKPA- s/Zyra Vendore	Fondi per projektet e mbartura nga viti 2021	Stoku			Subjektet			Nevojat e ZP 2022			Pikezim i	Fondi i shperndare per programet e reja për vitin 2022	Total Pjese marre s ne PNP	Prej totalit			
		Vlera	%	ponderim	Vlera	%	ponderim	Numer pjesem arresish	%	ponderim				PA K	Ro me/ Egji ptia ne	NE	Pu.Pa te tjere
BERAT	5,932,249	2,732	3%	0.3	1,611	3%	0.40	102.00	5%	0.30	0.04	10,850,772	65	2	6	6	51
BERAT	3,385,336	1,409	2%	0.3	789	2%	0.40	43.00	2%	0.30	0.02	5,106,879	29	1	5	4	19
KUCOVE	1,279,506	749	1%	0.3	545	1%	0.40	38.00	2%	0.30	0.01	3,631,714	24	-	1	1	51
SKRAPAR	1,267,407	574	1%	0.3	277	1%	0.40	21.00	1%	0.30	0.01	2,112,179	12	1	-	1	10
DIBER	3,447,249	4,962	6%	0.3	1,029	2%	0.40	144.00	7%	0.30	0.05	13,413,468	83	1	3	25	54
DIBER	2,947,249	1,550	2%	0.3	635	1%	0.40	56.00	3%	0.30	0.02	5,399,330	32	1	2	9	20
BULQIZE	500,000	1,150	1%	0.3	203	0%	0.40	30.00	1%	0.30	0.01	2,885,820	18	-	1	4	13
MAT		2,263	3%	0.3	191	0%	0.40	58.00	3%	0.30	0.02	5,128,318	33	-	-	12	21
DURRES	35,798,266	6,976	8%	0.3	3,824	8%	0.40	267.00	13%	0.30	0.10	33,063,949	218	2	8	4	204
DURRES	29,458,718	5,529	7%	0.3	3,251	7%	0.40	229.00	11%	0.30	0.08	28,646,061	192	1	5	2	184
KRUJE	6,339,548	1,447	2%	0.3	573	1%	0.40	38.00	2%	0.30	0.02	4,417,888	26	1	3	2	20
ELBASAN	29,984,236	10,674	13%	0.3	3,295	7%	0.40	130.00	6%	0.30	0.09	24,258,952	130	3	32	47	48
ELBASAN	20,824,923	6,875	8%	0.3	2,009	4%	0.40	52.00	2%	0.30	0.05	14,070,205	72	2	23	26	21
GRAMSH	2,563,542	1,327	2%	0.3	370	1%	0.40	22.00	1%	0.30	0.01	3,153,862	17	1	2	6	8
LIBRAZHD	3,588,408	1,354	2%	0.3	638	1%	0.40	35.00	2%	0.30	0.02	4,359,650	27	-	2	8	17
PEQIN	3,007,363	1,119	1%	0.3	278	1%	0.40	21.00	1%	0.30	0.01	2,675,236	14	-	5	7	2
FIER	35,192,438	10,421	13%	0.3	5,148	11%	0.40	206.00	10%	0.30	0.11	31,585,125	199	4	10	19	166
FIER	29,256,798	4,837	6%	0.3	3,593	8%	0.40	108.00	5%	0.30	0.06	18,098,601	119	1	4	6	108
LUSHNJE	5,038,204	4,099	5%	0.3	1,121	2%	0.40	73.00	3%	0.30	0.03	9,892,388	58	2	6	11	39
MALLAKA	897,436	1,485	2%	0.3	434	1%	0.40	25.00	1%	0.30	0.01	3,594,137	22	1	-	2	19
GJIROKAST	20,560,679	4,521	5%	0.3	1,135	2%	0.40	212.00	10%	0.30	0.06	16,826,820	105	3	7	7	88
GJIROKAST	10,546,761	1,993	2%	0.3	421	1%	0.40	104.00	5%	0.30	0.03	8,135,125	49	2	5	2	40
TEPELENI	6,520,254	1,400	2%	0.3	249	1%	0.40	50.00	2%	0.30	0.01	4,061,321	26	-	2	3	21
PERMET	3,493,664	1,128	1%	0.3	465	1%	0.40	58.00	3%	0.30	0.02	4,630,374	30	1	-	2	27
KORÇE	4,315,777	6,124	7%	0.3	2,317	5%	0.40	179.00	8%	0.30	0.07	19,163,697	115	1	15	22	77
KORÇE	2,121,205	2,298	3%	0.3	1,164	3%	0.40	90.00	4%	0.30	0.03	8,830,151	51	1	9	7	34
DEVOLL	1,167,799	836	1%	0.3	200	0%	0.40	35.00	2%	0.30	0.01	2,757,493	18	-	1	2	15
KOLONJE	966,413	726	1%	0.3	153	0%	0.40	26.00	1%	0.30	0.01	2,166,974	15	-	-	2	13
POGRADE	60,360	2,264	3%	0.3	800	2%	0.40	28.00	1%	0.30	0.02	5,409,079	31	-	5	11	15
KUKES	2,674,310	6,547	8%	0.3	611	1%	0.40	85.00	4%	0.30	0.04	11,647,515	66	1	2	43	20
KUKES	2,674,310	4,243	5%	0.3	279	1%	0.40	55.00	3%	0.30	0.03	7,259,287	41	1	1	27	12
HAS	-	1,175	1%	0.3	176	0%	0.40	15.00	1%	0.30	0.01	2,242,279	13	-	-	9	4
TROPOJE	-	1,129	1%	0.3	156	0%	0.40	15.00	1%	0.30	0.01	2,145,950	12	0	1	7	4
LEZHE	4,703,596	4,245	5%	0.3	2,478	5%	0.40	90.00	4%	0.30	0.05	14,041,956	90	1	5	11	73
LEZHE	2,369,806	1,381	2%	0.3	1,278	3%	0.40	40.00	2%	0.30	0.02	6,152,220	40	-	3	2	35
LAC	1,377,554	2,178	3%	0.3	927	2%	0.40	27.00	1%	0.30	0.02	5,590,778	35	1	1	6	27
MIRDITE	956,236	687	1%	0.3	273	1%	0.40	23.00	1%	0.30	0.01	2,298,958	15	-	1	3	11
SHKODER	52,521,820	7,047	8%	0.3	3,346	7%	0.40	285.00	13%	0.30	0.09	32,693,506	211	4	4	17	186
SHKODER	44,684,268	5,290	6%	0.3	2,718	6%	0.40	214.00	10%	0.30	0.07	26,494,341	170	4	4	10	152
M.MADHE	6,599,763	1,154	1%	0.3	378	1%	0.40	50.00	2%	0.30	0.01	4,123,289	28	-	-	3	25
PUKE	1,237,789	603	1%	0.3	250	1%	0.40	21.00	1%	0.30	0.01	2,075,876	13	-	-	4	9
TIRANE	56,674,526	12,849	15%	0.3	16,649	36%	0.40	260.00	12%	0.30	0.23	51,879,314	325	5	21	30	269
TIRANE	53,127,539	10,152	12%	0.3	15,759	34%	0.40	260.00	12%	0.30	0.21	46,931,795	298	5	14	21	258
KAVAJE	3,546,987	2,697	3%	0.3	890	2%	0.40	0.00	0%	0.30	0.02	4,947,519	27	-	7	9	11
VLORE	13,960,987	5,823	7%	0.3	5,101	11%	0.40	158.00	7%	0.30	0.09	24,808,793	158	3	5	19	131
VLORE	13,263,490	3,755	5%	0.3	2,902	6%	0.40	109.00	5%	0.30	0.05	15,338,888	97	2	4	10	81
DELVINE	191,707	734	1%	0.3	162	0%	0.40	20.00	1%	0.30	0.01	1,955,884	13	-	-	3	10
SARANDE	505,790	1,333	2%	0.3	2,037	4%	0.40	29.00	1%	0.30	0.03	7,514,021	48	1	1	6	40
Total	265,766,133	82,921	100%		46,544	100%		2,118			1	284,233,867	1,765	30	118	250	1,367

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**Njoftim**

Termat e referencës për fushat e veprimtarisë, financimin, kriteret dhe procedurat e aplikimit, si dhe kriteret dhe procedurat e vlerësimit të aplikimeve për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet

Vendimin nr. 535, datë 8.7.2020 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”

1. Të përgjithshme***1.1. Qëllimi i programit***

Programi i punëve publike në komunitet (PPPK) është një program 12-mujor, i cili ka qëllim përfshirjen në tregun e punës të punëkërkesve të papunë afatgjatë (të cilët kanë më shumë se një vit të regjistruar si të papunë) nëpërmjet ofrimit të mundësive të trajnimit dhe të punësimit me kohë të pjesshme në aktivitete me fokus shërbimet në dobi të komunitetit. PPPK u ofron mundësi të papunëve afatgjatë që të përfitojnë përvojë të vlefshme pune dhe të marrin pjesë në trajnim e në të njëjtën kohë të paguhen.

Programi i punëve publike në komunitet (PPPK) synon:

- a) të përmbushë nevojat e pjesëmarrësve, punëkërkesve të papunë;
- b) të përmbushë nevojat vetjake të punëdhënësit (organizatës) për punë të dobishme në të mirë të komunitetit.

Programi i punëve publike në komunitet zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) nëpërmjet Strukturave të saj në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile, organizata jofitimprurëse (OJF), biznese sociale / ndërmarrje sociale / sipërmarrje sociale dhe institucione publike, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e kësaj Agjencie, përfshirë aspektet financiare, ato të menaxhimit dhe të trajnimit.

1.2. Tiparet kryesore dhe zbatimi i programit

Elementet thelbësore të zbatimit të këtij programi janë punësimi (me kohë të pjesshme), këshillimi intensiv dhe trajnimi i pjesëmarrësve në program. Çdo pjesëmarrës do të përfitojë nga mundësi trajnimi

Organizatave zbatuese do të angazhohen në përzgjedhjen e pjesëmarrësve, identifikimin e nevojave të tyre për trajnim në vendin e punës, si dhe nevojave për aftësi të buta dhe aftësi bazë. Në vijim të identifikimit të nevojave, organizata zbatuese – nëpërmjet mbikëqyrësit – do të hartojë planin individual të trajnimit dhe do të mbështesë dhe mentorojë zhvillimin personal dhe përgatitjen për integrimin në tregun e punës të pjesëmarrësit pas përfundimit të programit.

1.3. Roli i mbikëqyrësit

Një nga rolet kryesore për zbatimin e çdo projekti në kuadër të programit të punëve publike në komunitet është roli i mbikëqyrësit, i cili do të jetë përgjegjës për të koordinuar, mbështetur dhe mentoruar çdo pjesëmarrës në program. Më specifikisht, mbikëqyrësi do të jetë përgjegjës për

përzgjedhjen e çdo pjesëmarrësi në program në përputhje me profilin dhe kërkesat e vendit të punës, hartimin dhe koordinimin e zbatimit të planit individual të trajnimit, mbështetjen dhe mentorimin, si dhe përgatitjen e çdo pjesëmarrësi për t'u integruar në tregun e punës pas përfundimit të programit. Përshkrimi i detajuar i punës i mbikëqyrësit gjendet në aneksin 1/1 të këtij dokumenti.

Mbikëqyrësi ka përvojë pune në fushën e këshillimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të burimeve njerëzore për pozicionet e punës në projekt, ka përvojë pune në menaxhim projektësh, këshillim dhe trajnim të të rriturve. Mbikëqyrësi kupton dhe është i aftë të kryejë të gjitha detyrat sipas kërkesave të programit dhe ka kualifikimet e nevojshme në fushën e zhvillimit të burimeve njerëzore. Kriteret e plota për angazhimin e mbikëqyrësit gjenden në aneksin 1/2 të këtij dokumenti.

1.4. Mënyra e financimit

Financimi i mbështetjes bëhet nëpërmjet rimbursimit të shpenzimeve, çdo muaj, pas vërtetimit të shpenzimeve.

2. Kriteret dhe procedurat e aplikimit

2.1. Kriteret e aplikimit për punëdhënësin

Për të aplikuar në këtë program, punëdhënësi duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- a) Punëdhënësi, i regjistruar në zyrën e punës, me të drejtë përfitimi për këtë program, është:
 - i. organizatë jofitimprurëse,
 - ii. organizatë të shoqërisë civile,
 - iii. biznes social / sipërmarrje sociale /ndërmarrje sociale,
 - iv. institucion publik
- b) Punëdhënësi është i specializuar në një nga fushat e veprimtarisë së PPPK sipas kreut I Pika 3 “Fushat e veprimtarisë së programit të punëve publike në komunitet” të VKM-së .
- c) Punëdhënësi është i regjistruar sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe kryen aktivitete në përputhje me qëllimin e përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij.
- d) Punëdhënësi ka shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- e) Punëdhënësi është i gatshëm të mbartë të gjitha përgjegjësitë dhe detyrimet e mbikëqyrjes dhe të punësimit, sipas legjislacionit në fuqi.
- f) Punëdhënësi ka të drejtën të aplikojë për maksimumi 2 (dy) grupe me numër jo më të madh se 7 (shtatë) punëkërkues të papunë për secilin grup.
- g) Punëdhënësi është i gatshëm të angazhojë një mbikëqyrës, sipas përshkrimit të punës në aneksin 1/2 për çdo grup përfutuesish nga 1 në 14 pjesëmarrës, i cili mund të punojë deri në 40 orë në javë, sipas kriterëve të përcaktuar në aneksin 1/2 të këtij dokumenti.

2.2. Kriteret e aplikimit për punëkërkuesin:

Punëkërkuesi duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- a) Punëkërkuesi duhet të jetë i regjistruar pranë zyrës së punës si punëkërkues aktiv, për jo më pak se 12 muaj;
- b) të jetë në moshë mbi 25 vjeç, dhe të ketë marrë shërbimet e nevojshme të punësimit, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga specialisti përkatës i punësimit.

- c) Nevojat dhe profili i punëkërkuessit duhet të përshtaten me kërkesat për aftësi të vendit të punës që siguron programi për ta.
- d) Një punëkërkuess mund të marrë pjesë vetëm një herë në këtë program, brenda një periudhe pesëvjeçare.

2.3.Procedura e Aplikimit

1. Punëdhënësit mund të aplikojnë për përfshirjen në program PPPK, në rrugë elektronike në adresën: <https://puna.gov.al/profili/punedhenes/punaKomunitet> apo fizikisht në zyrën përkatëse të punësimit dhe duhet të dorëzojnë dosjen e plotë fizike të aplikimit në strukturën përkatëse rajonale të punësimit.
2. Aplikimi përbëhet nga dokumentacioni i mëposhtëm:
 - a) Formulari i aplikimit të plotësuar, sipas modelit standard të miratuar dhe publikuar nga AKPA.
 - b) Autorizimi i punëdhënësit, me të cilin autorizohet struktura rajonale e punësimit të AKPA-së për të kryer të gjitha verifikimet dhe kërkimet e nevojshme të dokumenteve dhe të dhënave të aplikimit sipas formatit të publikuar nga AKPA.
 - c) Vetëdeklarim se nuk ka shkelje apo sanksione që lidhen me legjislacionin e punës, gjatë dy viteve të fundit, sipas formatit.
 - d) Vetëdeklarim se programi i punës së punëdhënësve nuk ka pjesë të tij asnjë promovim /advokim të:
 - i. një partie specifike politike ose të politikave të një partie specifike politike;
 - ii. një besimi specifik, kishe, përveç rasteve, kur projekti kufizohet qartësisht tek anëtarët/ithtarët e asaj kishe/atij besimi;
 - iii. Ndonjë kulti(laik ose fetar)
 - e) Vendimi i regjistrimit nga gjykata e rrethit gjyqësor, origjinal ose fotokopje e noterizuar (vetëm për organizatat);
 - f) Statuti i organizatës, origjinal ose fotokopje e noterizuar (vetëm për organizatat);
 - g) Ekstrakt i regjistrimit të organizatës nga gjykata, i marrë brenda një periudhe 3-mujore, para aplikimit;
 - h) Vërtetim për pagimin e detyrimeve tatimore ku konfirmohet që nuk ka detyrime.
 - i) Licencë/Leje për ushtrim veprimtarie origjinal ose fotokopje
 - j) Kopje e noterizuar e NIPT-it (vetëm organizatat);
 - k) Licensë/Leje për ushtrim veprimtarie origjinal ose fotokopje e noterizuar, për të gjitha ato aktivitete/veprimtari, të cilat nuk mund të kryhen pa zotëruar një licensë të akorduar nga autoritetet publike.
3. Organizata aplikuese është përgjegjëse që t'i japë Strukturave Rajonale të AKPA-së të dhëna lidhur me gjendjen aktuale të shlyerjes së detyrimeve tatimore përpara nisjes së projektit.

2.4.Afatet e aplikimit

1. Organizatat jofitimprurëse, organizatat e shoqërisë civile, bizneset sociale/sipërmarrje sociale/ndërmarrjet sociale dhe institucionet publike, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushat e përcaktuara në kreun I, pika 3 “Fushat e veprimtarive të programit të punëve publike në komunitet” të cilat përmbushin kriteret sipas pikës 4 “Kriteret për punëdhënësit” të kreut III “Kriteret e aplikimit”, ftohen të aplikojnë në rrugë elektronike në adresën:

<https://puna.gov.al/profili/punedhenes/punaKomunitet> apo fizikisht në zyrën përkatëse të punësimit dhe duhet të dorëzojnë dosjen e plotë fizike të aplikimit.

2. Afati për fillimin e aplikimeve nga Punëdhënësit është data e publikimit të shpalljes për aplikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të APP .
3. Punëdhënësit me të drejtë aplikimi me fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2022 do të lidhin kontrata brenda afateve ligjore.
4. Subjektet aplikuese për këtë program mund të drejtojnë pyetje, në çdo kohë në adresën e - emailit: kontakt@akpa.gov.al ose në Drejtoria Rajonale e AKPA-s .

3. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit

3.1. Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i aplikimeve do të bëhet bazuar në kriteret e mëposhtme:

Kriteri A: Cilësia, rëndësia e aplikimit dhe përputhshmëria me qëllimin e PPPK – 60%

Kriteri B: Kapacitetet e organizatës për zbatimin e projektit – 40%

3.2. Procedurat dhe afatet e vlerësimit

1. Struktura rajonale e punësimit, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga momenti i aplikimit, verifikon plotësimin e kushteve formale paraprake të aplikimit dhe përputhshmërinë e tij me rregullat e zbatueshme të programit. Në rast të mosplotësimit të kushteve paraprake, struktura rajonale e punësimit i kërkon aplikuesit plotësimin e dokumentacionit
2. Në rast të plotësimit të kushteve të aplikimit (pas verifikimit administrativ) në bashkëpunim me strukturën vendore të punësimit dhe punëdhënësin, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga momenti i plotësimit të dokumentacionit, hartohet lista e pjesëmarrësve punëkërkues të papunë në program, plani individual i trajnimit (PIT) për çdo punëkërkues pjesëmarrës në program dhe projekti paraqitet në Komisionin e Miratimit të Programeve të Nxitjes së Punësimit në Drejtorinë Rajonale të Punësimit.
3. Komisioni vlerëson secilin aplikim, brenda 5 (pesë) ditëve pune, me qëllim miratimin ose refuzimin e tij në përputhje me kriteret e vlerësimit.
4. Struktura rajonale e punësimit i komunikon punëdhënësit aplikues përgjigjen përfundimtare mbi pranimin apo refuzimin e aplikimit, brenda 2 (dy) ditëve pune.

4. Mbështetja e përfituesve

1. Punëdhënësi përfitues, sipas pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi, përfiton një grant për të financuar shpenzimet.
2. Për punëkërkuesit e papunë, pjesëmarrës në program, financimet janë, si më poshtë vijon:
 - a. Financim i pagës në shumën 50% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi .
 - b. Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.

- c. Kupon për trajnim të punëkërkuarve të papunë, pjesëmarrës në program, deri në 20.000 (njëzet mijë) lekë, në rastet kur trajnimet e miratuara nuk ofrohen nga ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional.
 - d. Për përfituesit jetimë që përfitojnë nga ky status edhe pasi kanë kaluar moshën 25 vjeç, sipas legjislacionit në fuqi, prindër të vetëm me fëmijë nën 6 vjeç, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, përfitues të ndihmës ekonomike, romë dhe egjiptianë mbulohen edhe shpenzime të tjera, si më poshtë vijon:
 - i. Bonus për shpenzimet e transportit mbulohen për të gjitha kategoritë e mësipërme, të cilët e kanë vendbanimin mbi 2 km nga vendi i punës, në vlerën prej 1.600 (një mijë e gjashtëqind) lekësh në muaj;
 - ii. Për prindërit e vetëm me fëmijë nën gjashtë vjeç jepet bonus në vlerën prej 3.000 (tre mijë) lekësh në muaj, për ndjekjen e kopshteve dhe të çerdheve për çdo fëmijë në ngarkim;
 - iii. Financim deri në shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë për një person, por jo më shumë se 200.000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona, për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara.
3. Për punëdhënësin, pjesëmarrës në program, financimet janë, si më poshtë vijon:
- a. Për mbikëqyrësin financim të pagës në shumën:
 - I. 50% të pagës mesatare në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për grupin nga 1-7 punëkërkuar të papunë pjesëmarrës, për 20 orë në javë;
 - II. 100 % të pagës mesatare në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për grupin nga 1-14 punëkërkuar të papunë pjesëmarrës, për 40 orë në javë.
 - b. Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës mesatare në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.
 - c. Tarife për mbulimin e shpenzimeve materiale të nevojshme për zbatimin e projekteve të punësimit në komunitet, në shumën totale deri në 10.000 (dhjetë mijë) lekë për çdo përfitues, këto të justifikuara me fatura tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Granti disbursohet në këste. Kësti i parë prej 20% jepet pas nënshkrimit të kontratës për të mbuluar shpenzimet e para të projektit dhe në vijim, çdo muaj, pas vërtetimit të shpenzimeve.

Aneks 1/1:

Përshkrimi i punës i mbikëqyrësit në Programin e Punëve Publike në Komunitet (PPPK)

Pozicioni i punës: Mbikëqyrës në programin e punëve publike në komunitet (PPPK)

Përgjegjësitë kryesore:

- Të garantojë menaxhimin dhe koordinimin efikas dhe eficient të burimeve njerëzore, financiare dhe materiale të skemës PPPK dhe të raportojë pranë Komitetit të Menaxhimit të Projektit/ Menaxherit të projektit të Punëdhënësit, zbatues të PPPK për zbatimin e saj.

- Të mbështesë dhe mentorojë pjesëmarrësit në PPPK për të përfutur aftësitë, kompetencat dhe kualifikimet në përgatitjen për punësim.

Fushat kryesore të funksioneve të mbikëqyrësit

Administrimi

- Të instalojë dhe menaxhojë sistemin e regjistrimit efikas të kohës për pjesëmarrësit në skemë
- Të ndërveprojë me nëpunësin e AKPA-së vendore, sipas nevojës.

Ofrimi i trajnimit dhe zhvillimit

- Të kryejë identifikimin e nevojave të pjesëmarrësit sipas individëve, sipas nevojës, në kuadër të procesit të planit të trajnimit individual.
- Të identifikojë nevojat dhe të sigurojë e koordinojë mundësi ekonomike për trajnim dhe zhvillim në pajtim me udhëzimet e prokurimit të AKPA-s.
- Të përgatisë një plan individual mësimor (PIT) për çdo pjesëmarrës dhe t'i vendosë në dosje sipas procedurave të PPPK.
- Të garantojë akses në kualifikime të njohura për pjesëmarrësit, me fokus në arritjen e kualifikimeve përkatëse, duke përfshirë vlerësime në nivel të ulët dhe të lartë ose standarde të lidhura me industrinë.
- Të planifikojë dhe prokurorë mundësi trajnimi përkatëse të cilat janë miratuar nga AKPA.
- Të mbajë dhe përditësojë të dhënat e trajnimit për secilin pjesëmarrës në projekt, si pjesë e planeve të tyre individuale mësimore.
- Të monitorojë dhe rishikojë inputet e trajnimit me pjesëmarrësit.
- Të planifikojë dhe organizojë vendosje në punë – brenda dhe jashtë ndërmarrjes, sipas kërkesës

Burimet njerëzore

- Të koordinojë rekrutimin e aplikantëve në PPPK në pajtim me proceset e referimit dhe të rekrutimit të AKPA-s për PPPK.
- Të planifikojë dhe koordinojë planet e miratuara të punës dhe të garantojë se kontratat vjetore të punësimit janë të rregullta për pjesëmarrësit.
- Të komunikojë me efikasitet me të gjithë pjesëmarrësit në skemë, duke përdorur takimet në grup dhe takimet formale e informale “kokë më kokë”.
- Të zhvillojë një dakordësi të përbashkët me pjesëmarrësit lidhur me nevojat e tyre për të rihyrë në punë në rastin e pjesëmarrësve që kanë qenë për shumë kohë të papunë dhe që kanë nevojë të zhvillojnë një rrugëtim të qartë progresi.
- Të kryejë aktivitete me fokus kërkimin e punës së bashku me pjesëmarrësit.
- Të ndërveprojë me punëdhënësit për të promovuar progresin drejt punës dhe të punojë me organizata të tjera mbështetëse, sipas nevojës.
- Të zhvillojë një plan daljeje me secilin pjesëmarrës.
- Të menaxhojë burimet e stafit, sipas nevojës.
- Të angazhohet në trajnim dhe zhvillim, sipas nevojës.
- Të raportojë rregullisht pranë Komitetit të Menaxhimit të Projektit të Punëdhënësit, Zbatues i PPPK.

Menaxhimi i skemës

- Të ofrojë një mjedis të sigurt dhe të shëndoshë për pjesëmarrësit, qoftë sa i përket ambienteve po ashtu edhe praktikave të punës.
- Të sigurojë se vendosjet në punë në skemë janë në pajtim me aplikimin në PPPK.
- Të supervizojë, rakordojë dhe menaxhojë pjesëmarrësit.
- Të marrë pjesë në të gjitha mundësitë për trajnim dhe zhvillim që ofrohen nga Punëdhënësi dhe nga Drejtoria Rajonale e AKPA-s, sipas kërkesave të postit të punës.
- Të kryejë të gjitha funksionet përkatëse për pozicionin e mbikëqyrësit në PPPK, sipas udhëzimeve të (Punëdhënësit).

Progresi i pjesëmarrësve në PPPK

- Të kryejë planifikimin e daljes nga programi
- Të kryejë aktivitete intensive të kërkimit të punës si pjesë e planifikimit të daljes
- Të mbajë evidencat e angazhimit me punëdhënësit lokalë
- Të mbajë një bazë të përditësuar të dhënash të punëdhënësve.

Aneks 1/2: Kriteret për angazhimin e mbikëqyrësit në PPPK

Pozicioni i punës: Mbikëqyrës në projekt në kuadër të Programit të Punëve Publike në Komunitet (PPPK)

Raporton pranë: Komitetit Menaxhues të projektit – drejtuesit të organizatës së punëdhënësit

Kualifikimi/et:

- Të ketë diplomë universitare të paktën të nivelit Bachelor ose të barasvlershëm në: administrim biznesi, menaxhim burimesh njerëzore ose fusha të tjera të lidhura me veprimtarinë e punëdhënësit dhe pozicionet e punës në PPPK.
- Të ketë njohuri shumë të mira të përdorimit të teknologjisë së informacionit (MS-Office)

Njohuri për pozicionin e punës:

- Të kuptojë dhe të jetë i aftë të kryejë të gjitha funksionet dhe detyrat e rolit të mbikëqyrësit në projekt në kuadër të PPPK;
- Të demonstrojë angazhim dhe motivim për të zbatuar objektivat e PPPK.
- Të ketë aftësi shumë të mira të hartimit të raporteve.

Përvoja e punës

- Të ketë përvojë të mëparshme në fushën e këshillimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të burimeve njerëzore për pozicionet e punës në projekt (minimumi 3 vjet).
- Të ketë përvojë të mëparshme në administrim, menaxhim projektsh dhe trajnim të të rriturve apo pozicione të ngjashme me to.
- Të ketë përvojë pune me individë dhe punëkërkues nga grupet në nevojë.
- Të jetë i aftë të punojë nën drejtimin e Organizatës Drejtuese për zbatimin me efikasitet të programit PPPK, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat e zbatimit të këtij programi.

Aftësi ndërpersonale

- Të ketë aftësi të mira komunikimi
- Të ketë aftësi shumë të mira të hartimit të raporteve
- Të jetë i aftë të udhëzojë, motivojë, instruktojë dhe mentorojë punëkërkesit.

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Njoftim për vend të lirë pune

Në mbështetje të VKM Nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror” i ndryshuar, Shërbimi Social Shtetëror shpall konkurimin për pozicionin e lirë të punës:

Përgjegjës Sektori, kategoria III-b, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Kandidati/ja që kërkon të punësohet në këtë vend pune duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në Shkenca Shoqërore (Juridike/ Sociale) dhe “Diplomë Bachelor” në të njëjtën fushë me diplomën master.
4. Preferohet të ketë eksperiencë pune 2 vite përvojë në profesion;
5. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
6. Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
7. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
8. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 22.04.2022, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Çertifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune.

Pas verifikimit paraprak në datën 25.04.2022, do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej konkurimin, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.